



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri

Mbledhja nr. 41

Prishtinë, më 09 shkurt 2010

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

Mbledhja filloi në orën 11:00

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Morën pjesë anëtarët e Komisionit: Rustem Mustafa, Eqrem Kryeziu, Shkumbin Demaliaj, Zylfi Merxha, Suzana Novoberdaliu, Zafir Berisha dhe Melihate Termkollli.

Munguan: Lulzim Zeneli dhe Bojan Stojanoviq.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj, Nuredin Ibishi, Blerina Pula dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi: Rustem Mustafa, kryetari i Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të datës **27. 01. 2010**,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë,
5. Të ndryshme.

***Kryetari** konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të 27. 01. 2010

Procesverbali i 27. 01. 2010 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale

Kryetari i Komisionit – Tha se para se të fillojmë shqyrtimin e amendamenteve, kam një vërejtje për lektorimin dhe për përkthimin e projektligjeve, sepse nuk janë duke i bërë si duhet. Unë do të kërkoj në seancë plenare nga kryeparlamentari që të shqyrtohet mundësia për punësim të personave, në mënyrë që këto projektligje të vijnë pa gabime. Ju e dini se deputetja Suzana Novoberdaliu ka qenë referuese e Projektligjit dhe përpara vetes keni amendamentet e propozuara për këtë projektligj.

Një numër i madh i amendamenteve është propozuar për këtë projektligj, që janë më shumë të natyrës teknike, por që është dashur të intervenohet për të mos lejuar ndonjë lëshim.

Suzana Novoberdaliu – Unë, si referuese, së bashku me grupin e punës kemi punuar në shqyrtimin e Projektligjit dhe nxjerrjen e amendamenteve. Kemi mbajtur edhe një punëtori për këtë projektligj, ku ka qenë i ftuar eksperti gjerman, autori i Projektligjit. Me pjesëmarrjen e tij janë sqaruar shumë çështje që ishin të rëndësishme. Unë mendoj se duhet të shikohet përkthimi në gjuhën serbe, të bëhet sa më mirë.

Eqrem Kryeziu - E kisha lutur referuesen të na tregojë, nëse ka ndonjë ndryshim përmbajtësor, për të ndërhyrë nga ana jonë. Sa i përket këtyre çështjeve të tjera teknike, unë pajtohem me kryetarin që amendamentet t'i votojmë në tërësi.

Shkumbin Demaliaj - Për këtë projektligj është bërë një punë e madhe, por ka pasur ndërhyrje të shumta. Në lidhje me këtë projektligj janë mbajtur takime dhe janë marrë këshilla nga konsulentët ndërkombëtarë. Unë mendoj se nëse ka ndonjë ndryshim më përmbajtësor mund ta diskutojmë, ndërsa për ndryshimet e tjera mund të votojmë.

Melihate Termkollit - Me rregullore të punës së Kuvendit, çdo ndërhyrje e vogël duhet të jetë amendament. Mirëpo, unë mendoj që si amendamente duhet të jenë çështjet esenciale. Sa i përket këtij projektligji është punuar mirë, e edhe në debat publik është trajtuar shumë. Kemi thënë se ky projektligj është prej projektligjeve tejet i rëndësishëm.

Kryetari i Komisionit i ftoi që këto amendamente t'i votojnë në tërësi, kështu siç janë, që të procedohen më tutje.

Suzana Novoberdaliu – Tha se te amendamenti i 84 ka mbetur si çështje për t'u diskutuar në Komision, çështja e dispozitave ndëshkuese. Si propozim ka qenë që shumat të përgjysmohen, por prapëseprapë mbetet te Komisioni se si vendosin për dispozitat ndëshkuese.

Melihate Termkoll - Unë mendoj se dispozitat ndëshkuese duhet të mbeten ashtu siç janë në Projektligj, sepse po flitet për një lëmi shumë sensitive. Nëse këtu do të ketë shkelje, pasojat do të jenë shumë të mëdha.

Anëtarët e Komisionit miratuan raportin me amendamente për Projektligjin.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë

Kryetari i Komisionit – Tha se kam qenë referues për këtë projektligj. Edhe Projektligji për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë ka përfunduar së shqyrtuari në grupin e punës. Raporti me rekomandime për këtë projektligj përmban ndryshimet e plotësimet që janë bërë në kuadër të grupit të punës. Unë dua të sqaroj amendamentin e parë. Në titull dhe në tërë tekstin e Projektligjit fjala “informatë” të zëvendësohet me fjalën “*informacion*”, si një çështje esenciale. Amendamenti 42, që është vendosja e afatit për zbatim të Projektligjit, duhet të diskutohet.

Melihate Termkoll – Tha se amendamenti 42 nuk mendoj se duhet të jetë kështu. Duhet të riformulohet teksti i nenit dhe të caktohet afati kohor brenda një viti.

Anëtarët e Komisionit miratuan raportin me amendamente për Projektligjin.

5. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit – Tha se herën e fundit kemi mbajtur një mbledhje të jashtëzakonshme për pakënaqësitë e shfaqura nga Policia e Kosovës. Ne, si Komision, kemi dalë me një rekomandim, që i është dërguar zyrës së Kryeministrit për tejkalimin e kësaj gjendje. Unë kam një propozim, të kërkojmë një informatë në detaje për këtë çështje. Unë jam në dijeni se ç'ka ndodhur në vendet e rajonit, kur njësitë speciale ndërmarrin hapa të tillë. Shqetësimi im do të jetë ende, nëse nuk ndërmerren masa aty ku duhet.

Suzana Novoberdaliu – Tha se unë e mbështeti mendimin tuaj që të kërkohej një informatë për situatën e krijuar. Mosardhja e MPB - së dhe Policia e Kosovës është e papërgjegjësishme nga ana e tyre. Nëse nuk do të ketë ndonjë masë ndëshkuese, kjo do të vazhdojë kështu.

Shkumbin Demaliaj – Këtu po bëhet një shkelje e trefishtë, sepse nuk ka mundësi Ministri e as Drejtori ta shkelin Ligjin për buxhet. Dhe t'i premtojë dikujt paga e të japë propozime të tjera, kur nuk janë bërë ndryshime në Ligjin për buxhet. Kjo është një shkelje e rëndë, që bëhet nga mekanizmat vartës.

Melihate Termkolli – Parlamenti nuk ka kontrollin në Qeveri. Qeveria e ushtron kontrollin e plotë ndaj Parlamentit. Përderisa ekziston kjo qeverisje, unë mendoj se asnjë hap nuk do të ndërmerret për ndonjë ndryshim. Kur Ministri nuk i përgjigjet Parlamentit ose ndonjë përfaqësues i tij, atëherë duhet të ndërmerren hapat e nevojshëm në lidhje me këtë. Para disa muajve në dhomën e dëshmive ka ndodhur një vjedhje në ditët tona, njësitë speciale hyjnë në greva, ndërsa askush nuk ndërmori asgjë. A mundemi ne, si Komision, të bëjmë një mocion votëbesimi për ministrin?

Zafir Berisha – Tha se ne, si Komision, gjendemi në situata pa rrugëdalje. Këtu duhet dikush të japë përgjegjësi. Ne kemi mbajtur takime dhe kemi dhënë rekomandime, por nuk janë shqyrtuar si duhet.

Kryetari i Komisionit – Tha se a pajtohen të kërkonin një informatë në hollësi për situatën e krijuar?

Anëtarët e Komisionit u pajtuan me propozimin e kryetarit.

Pasi që nuk kishte pika të tjera për diskutim, kryetari i Komisionit e mbylli takimin.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10

E hartoi:

Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Rrustem Mustafa